The background of the entire cover is an abstract painting. It features a complex composition of geometric shapes, primarily triangles and rectangles, in a variety of colors including deep blues, vibrant reds, bright yellows, and earthy browns. The texture is highly detailed, with visible brushstrokes and a sense of depth. In the upper left corner, there is a small, rectangular white label with a black border. Inside this label, the word 'BIBLIOTEKA' is printed in a simple, sans-serif font. Below it, the handwritten text '85H-1' is written in blue ink, followed by a horizontal line and then 'A 73' also in blue ink.

BIBLIOTEKA

85H-1
A 73

Poezi


In ~ tenebris...

FATOS ARAPI

8SH-1
A 73

FATOS ARAPI

In - tenebris...



54899

"Marin Barleti"

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese "Marin Barleti"

Tiranë, 1996

I.Akeronti rrjedh, po Karont nuk ka (Cikli i Vllasit)

“Unë kështu qesh brumosur,
që të mos e duroj
atë që më duket e padrejtë.
U revoltova kundër
saj dhe mora një tjetër qëndrim
për jetën time”.

Vllas Arapi

In - tenebris

Këtu fjala nuk bëhet dritë.
Këtu drita prej terri është.

Bebëz e syrit eklipsi i hënës.

Në rrugë pa rrugë njeriu:
shkon para kohës
e gjëkundi s'arrin, se gjëkundi s'ka.

Kujtesa këtu rron pa kujtesë.
Liria lind skllave këtu.

I vetmi ngushëllim tragjeditë, -
kurrë s'i harrojnë takimet me ty.

Këtu nuk ka nevojë për cerberë:
sapo kalon synorin e territ,
më i tmerrshëm njeriu:

Ai të vret.

Dhe ti beson se drita nuk vritet?

Kjo ëndërr kristalore e shpresës? -
Shpresa vritet, vëllai im, shpresa vritet.

Liria vritet, vëllai im, liria vritet.

Janë zogj të çmësuar të fluturojnë
dhe qiellin urrejnë.

Janë gjallesa terri,
batak krimba e krimesh, çaponjë të ndytë,
cmirë neveritëse, janë.

Bëhu dhunë që fyen syrin o, vëllai im,
këmbë që shtyp zërat e ndritshëm të vesës,
ligj i pacipë që prangon gurmazët. -

Do të adhurojnë.

Bëhu hije - veç prej lënde tiranësh:
do të adhurojnë.

Ti kërkon të jesh një pikëz drite
që xixon në fundet e syrit të verbër?

Dhe ti mendon se drita nuk vritet, vëllai im?

Akeronti rrjedh, po Karont nuk ka

Si të kthehem prapa kur udhën s'e di?
Prej pikëllimi lumi buçitës i natës
e unë rrah brigjet e errëta këtu.

Akeronti rrjedh, po Karont nuk ka.

Tregomë një va ku të kaloj.
Ti i njeh guvat e vorbullat e frikshme.
Tregomë një va, vëllai im,
ku të kaloj Akerontin
dhe të arrij.

Akeronti rrjedh, po Karont nuk ka.

Ke lindur për qiej të tjerë

Ke lindur për qiej të tjerë.
Nëpër gjumin e shprishur - prej gjumi të shprishur -
tjetër ëndërr le të ngrihet,
ta marrë për dore njeriun.
Të tjerë dhembë akrepi, në të dy skajet e dhimbjes,
të na i mbërthejnë zemrat.
Njeriu mund të këputet, si një shembje vjeshte,
por më dinjitoze rënia.
Dhe Fjala e Para mundet të thyet,
zgrip e zezonë...veç, të mundurit më burrërorë...
Të tjera liri le të jenë nënat
e tragjeditë të tjera; të tjerë
lotët e kripa e hidhur që gërryejnë
guvat e syve; tjetër bebëz'e verbuar
të ndezë përbrenda zogun e diellit.
E vjetër është drita, e vjetër,
tjetër duhet të jetë regtimi i shpirtit të saj.

Ke lindur për qiej të tjerë, vëllai im.

Dhe unë vajtoj
vdekjet e tua të ardhshme.

Nuk dua të bëhesh kujtim

Nuk dua të bëhesh kujtim, vëllai im.

Jemi ti edhe unë, apo jo?

Nuk dua të bëhesh kujtim, vëllai im,
të më flasësh me zë të harresës.

Zgërbonja e kohës kumbon

zë e pa zë; lundron arkivol

kujtimi i zi, e ti brenda tij.

Nga largësi të pavërteta, të paqena,

e kam vështirë të jap dorën;

të ndahemi për të fundit herë, si burrat,
që ndahen.

Jemi prej jete, apo jo?

Buzëqeshja e jote e mëngme, ironike,

tre kandilë të narciztë

ndezi te këmbët e vdekjes.

Afroj duart e nëpër shkrepje të flakës

dëgjoj vdekjen që po flet me vete.

S'ja vlen të trishtosh zemrën tënde

S'ja vlen të trishtosh zemrën tënde, vëllai im.

Prej pafajësie hyjnore dëshpërimi.

Më mirë gëzoju krizantemës,

që asnjë dorë përdëlluese,

s'e mbolli mbi varrin tënd.

Fli i lirisë së tyre? S'ja vlen...

Sytë ua vret drita e pyesin:

- "Pastaj, ç'do të bëjmë me lirinë?"

Janë gjuhë të stërlashta që vetëm lëpijnë

putrat e krimet; e presin prillin,

veç shiu bujar të jetë gjaku yt;

pastaj korbat të shpëlahen,

të shpupuriten pëllumba të bardhë.

S'ja vlen qiejt e dëshpëruar të syve të bukur,

vëllai im.

Le të jemi varrë - po i të tjera ëndrrave -

Tjetër flijim,

ku fyerja s'të arrin dot.

Të gjitha të duhen

Më e panevojshme se një përshëndetje në udhë
heroizma; gjithnjë
ka një mbrëmje që s'i duhet askujt.
Po ne si do të bënim pa sytë
tmerrësisht joshës
të intrigës? Shpirti
së prapthi e veshi lëkurën e vet,
qyteti të jep dhimbje koke; gjithnjë
ka një mëshirë që s'i vlen askujt.
Mushkритë e drejtësisë janë qelbësuar
dhe po i mjekojnë me ilaçe të skaduar.
Po ne si do të bënim
pa gojëzën e bukur,
kafshimin e errët të tradhëtisë?

Të gjitha të duhen, vëllai im.

Një nga një dritat e qiellit i shuan
sqepi i zogut në ag të agimit.
Dhe më e sinqertë është hipokrizia:
vejusha-dënesje, mbi vdekjen tënde
tani hedh trëndafilin e fundit:
Lavdinë, që s'i duhet askujt...

Sikur liria të ishte vetëm një lavire

Më i pafrikshëm se koha,
ti shkel mbi shkumbra të humbjes sate.

Dhe Zotin e vdekjes e sheh në sy.

Mirë, vëllai im, po s'është e drejtë
të ndahet kështu vëllai nga vëllai;
s'është e drejtë unë të jem
kujtimi fajtor që ecën
kërrusur, rënkonjës, nën shira përçmues,-
e rruginat e errëta s'i njeh,
nga të shkojë nuk di.

Si u jetoka me një zemër
që marka formën mallit për ty?

Të mjerët ne: as mbi veten ionë
s'i hedhim dot sytë:
Në të njëjtën pikë gjaku,
në të njëjtën qelizë - liria e krimi.
E të dy - fëmijë të mbrapshtë
qajnë e këlthasin se kanë thyer
neve, - lodrat e tyre. Duan lodrat nër duar...

Sikur liria të ishte vetëm një lavire! -
Eshtë mëmë laviresh, vëllai im, mëmë laviresh.

Pa Zotin e vdekjes mund ta shohim në sy.

Vet tragjedia kishte humbur udhën

Tragjedia

ajo printe udhën. E ne pas saj...
Duke hedhur andej e këndej pjesë të vetes.
E dinim se për ne s'kishte të nesërme,-
dhe vet ishim e ardhmja e saj.
Koskat e shpërbëra të skeletit
mbështillnim me buzëqeshje ironike
dhe e dinim: dikush tjetër
do të ngrihej, do të lartësohej,
prej lëndës së errët të sakrificës,
substancës prej nate të humbjes sonë.
Vetëm dhimbja që s'është anonime:
pyeteni zemrën tuaj,
si mundet shpresa të tradhëtoj vetveten?
Bishë e vogël koha,
tek ne kruante me kthetra trupin e vet,
idealet të shuante, krimet e datat.
Në angullimën e ujkut të plagosur,
nata verbuese dhe vet tragjedia
kishte humbur udhën,-
e kërkonte me pishë në dorë.
E ne pas saj...

Në bibliotekën tënde

Një cep
i përthyer i librit të zverdhur.
Përtej është koha ku s'mund të shkelim,
ne vrasësit e fateve tona.
Ky çip i përthyer i librit...
Ku zëri i nënës akoma s'është bërë dhimbje,
babaj s'është bërë harrim,
dhe na pëlqen që me zërat e vet
të na gënjejë deti.
Ky cep i përthyer libri...
O zot! Si largohemi kështu prej vetes.
Jo hija e panjohur,-
dora e dhunshme e kohës na shtyn
në këtë mjegullë të qulltë, të ndohtë,
krimesh, dritash e baltrash përzierë.
E s'kthehemi dot te ky cep i përthyer
i kësaj flete të zverdhur;
përtej, dielli është ngulur në një pikë
e s'luan. Atje, ku zëri i nënës
akoma s'është bërë dhimbje.

Të mjerët ne, o Vllasi, të mjerët në!
Dhe shpresa jonë kishte fluturuar, përpara
se ta prekte kutinë fatale Pandora.

Diell shpërfillës...

E ke të vështirë, vëllai im.
Je kupë e vrerët zhgënjimi
që derdhet edhe përtejvdekjes.
Të kujt janë duart që e mbajnë?

Oqean pikëllimi
pika e fundit e gjakut tënd.
Aty shuhesh si një diell shpërfillës.

As kryet s'kthen prapa.
S'pranon të përfalesh as me vdekjen.

Nuk është aq e pastër sa na shtiret.

Ti i fundit shpirt i furtunës

... po ikën dhe i fundit shpirt i furtunës.

Shputa e pelikanit u ngjesh
dhe shqeu ujërat hënorë:-
plagë e hapur për ty.
Nëna - që s'është më -
me grushte mbledh gjurmët e vogla
që ikin. Pulëbardha në qiell u nxi.

U bëre luftë, vëllaj im. Vetën harrove.
Dhe në lotin e motrës, u bëre luftë.

Liria përherë atje, në mesin e udhës.

Nesër sërish do ta vrasin.
Kanë harruar një kryqëzim tjetër.
Do ta mendojnë gjersa të ngatërrohet,
gjersa të pengohet nëpër thirrjen e fundit:
"Përse më le vetëm, o zoti im!".
Nesër, një nesër tjetër do të kryqëzojnë.

Liria atje, në mesin e udhës...

Ikën... shuhesh... ti i fundit shpirt i furtunës.

25 shkurt'95

Askush s'e ka parë diellin kështu

Atje poshtë një lum i nëndheshëm.
Këtu sipër një lum i mbidheshëm.

Ti i vdekur qanë.
Unë i gjallë po qajë.

Dhe sytë mbuloj me pëllëmbë,
të mos shoh hedhurinat, plehrat e shpirtrave,
përzjerë nëpër llucë e ndohtë.


Vëllai im! Vëllai im!
Askush s'e ka parë diellin kështu të qajë,
si ne të gjorët.

O zot, gjer kur këtij lumi të lotëve
do t'i mohohet gryka e detit.

Nëna u nisë

Nëna u nisë. Pikur
nga malli për ty, nëna u nisë.
Këndeji varrin s'ta gjetëm dot,-
u nisë andej.
Mos e lerë gjatë, mos e lodhë
duke të kërkuar. Të ka kërkuar mjaftë
nëpër ikona të vdekjeve të tua.
Nuk është e ré, që e njeh ti:
plakë me zemër sëmurë,
sytë e kanë lenë,
ka rënë tepër dhe trimërohet
e mbahet vetëm për hatrin tënd.
Mos e rraskapit andej duke të kërkuar,
mos e lodhë shumë nënën.
Dili përpara, për ta njohur:
lutje e përzishme, gjithnjë më pranë dheut,
gjithnjë më dhimbje...
Një kanistër të vogël në duar
ku kemi vënë pak bukë,
ca kokrra ullinj,
tre grushte grurë të zjerë,
tre qirinj të ndezur
për shpirtin tënd.

54 889



3 mars '93

Shpresa e çmëndur...

Vllasit

Unë ikja Evropës me sytë nën këmbë,
një mall që therr, një shpresë që çmënd.
Shpresoja diku mos ishe i gjallë,
të çmallesha diku me vëllain e vradë.
Përpara diku, prapa diku,
ishte dhe s'ishte Berna diku,
natë e rrëpirtë e Zyrihut diku.
Të ishe... të ishe... po s'dija seku...
Të mjerët shqiptarë me vdekjen në sy,
kërkojnë të çmallen me vdekjen diku.
Dhe çanë Evropës me sytë nën këmbë
shpresa e çmendur.

10 mars '93

Mall për ty në Tiranë

Vllasit

Eshtë tetor, vëllai im. Qielli i Tiranës
gjithë llucë ... dhe gjysmën e shpirtit, më pakëz,
e rrezon dielli; gjysmën tjetër, më shumë,
ma mbulon terri.

5 tetor '95

Ku është Kaini?

Mbrëmë në rrugën e ngushtë tiranase
takova Abelin gulçues që pyeste:

- Ku është Kaini?

Se unë - thoshte Abeli - duhet të vdesë,
patjetër duhet të vdesë.

A e ke parë Kainin?

Në fushën e errët të gjakut
mbijnë dhe ecin ullinjtë.

Dhe ti më lëshon nër duar
vdekjen tënde që thërret:

Ku është Kaini?

Përshpirtje për Vllasin...

Shën - Mëril Vetëm ti...

S'i gjejmë më dot shpirtrat tanë.

Tjetër dritë dhe tjetër errësirë kërkojnë. Vetëm ti...

Tjetër mëshirë në mëshirën e tyre kanë.

Mëkatarë, po! Në mijra shpirtra, shpirti ndahet.

Shpirti kërkon tjetër shpirt.

Shën - Mëril Dielli varet,

në fije rreze të këputur... dhe ndrit.

Faji s'na ndjek dot më pas. U lodh.

Tjetër gjyq i ngrehim vetvetes.

Tjetër paqë në paqen e botës,

Shën - Mëril Tjetër dritë në dritën e jetës.

22 shkurt '93

II. Zhgënjimi le të na bekojë

Shqiptarët

Në luftë flenë duke ecur.
Në vdekje vdesin duke ecur.
Në këngë qajnë shqiptarët
duke dëgjuar këngët e tyre si qajnë.
Në vdekje vdesin duke ecur...
Dhe këmbë e kalojnë
Akerontin e tyre prej gjaku.

1990

Mashtrojnë horizontet

Mashtrojnë horizontet në detin e hijëve.
Kujtesat përmyten në detin e hijëve.
Anije shkallmuar mes dallgëve të hijëve.
Humnerë nën humnerë tek unë,
një S.O.S. ndizet-shuhet:
Shpëtoni...
shpirtrat e hijëve.

Gusht 1991

Ka dalë Akeronti prej shtratit të vet...

Ka dalë Akeronti prej shtratit të vet.
Çmëndur prej dëshpërimit, Karonti i varfër,
i bie kokës me grushte:
- Ç'të bëj unë tani me barrën e shpirtrave?

Gjékundi... gjékundi... brigjet.

Ka dalë Akeronti prej shtratit të vet.

mars '91

Një pikëllim i lirë...

Tani unë jam liri.

Unë jam asgjëja e lirë.

Unë jam kurkushi i lirë.

Në një kujtim të lirë,-
një pikëllim i lirë.

Tani unë jam liri.

1992

Ngjarje

Unë po mendoja për Qezarin,
një zog ligjëronte mbi degë të akacies;
unë po mendoja për senatin,
zogu kishte kapur rrezën në sqep.
Senatorët togëbardhë
ngrinë në parandjenjën e mermertë të tyre.
Zogu po ndërtonte folenë.
Pastaj erdhi edhe mashkulli...
Ahere unë pash Brutin.
Brut, i thirra unë, zogu
prej ligjërimesh e rrezesh diellore
e ngriti folenë e vet.
Po Bruti s'e kishte mëndjen tek unë,
diçka po bënte prej Qezarit.

1987

Në varrezën e fshatit

Vaj'i kumrive mbush qiparisat
në varrezën e vogël ku zambakët janë tharë.
Këmbana e vjetër, e thyer
derdh zërat e ngjirur dhe muzgun.

Kryqet e gurtë shtrembër fundosen.

Të vdekurit falen tek unë.

Herë - herë Penelopës

Përpara dielli e zogjtë,
detet i krijon ti.
Erërat e vetëtimat mbas teje vinë,
ti vet u prinë fateve të pafatë të tua.

Me çip të syrit xixues sheh zotat,
që s'guxojnë të të afrohen.
Të nesërmen me ishuj të tjerë,
ti vet e mbush.

E mbetet diku Itaka.

Anija thyer shkembejsh lundron
atje, ku s'ka më brigje.

Tani, ç'mund të jesh tjetër,
veçse një mall gërryes për Itakën?

Asnjë dashuri s'e përçik më shpirtin tënd.
Dhe në shtratin e dhunuar bashkëshortor
herë - herë Penelopës
i thërret me emrin e Çirçes.

Dhe je Evropë.

Dhe je Evropë, por Evropa s'është vetëm ti.
Dhe je i vërtetë, po e vërteta s'është vetëm ti.
Mbetë katakombeve të shpresave të tua,
i pikëlluari im.

U lodh vdekja me ty, populli im.
S'di ç'të bëj vdekje me vdekjen tënde...
Kërkon t'i dredhojë, kthehet prapa,
merr udhë të tjera - e përpara ti!
Sheh vdekja duart e tua lidhur krahrorit:
aty shtrëngon fortë lirinë tënde.

Ç'të bëj vdekja me vdekjen tënde,
i pavdekshmi im.

Evropa e pakapshme si ndarja

Evropa një gjysëmëndërre,
një gjysëmbrenge Evropa.
Ngulur në qiellin e mjegullt,
dielli hedh te këmbët e mia,
si një gjysëmmëshirë-
një gjysëmfati.

Evropa e pakapshme si ndarja.

Ndarja e hutuar, përgjysëm
nga vaji i guguftuve.

Në ora 17 e 5' këmbanat e Shtutgardit
drithtërojnë qiellin.
Unë po falem për shqiptarët e mi
që këndeje shesin shpirtin
pa pare.

25 janar '94
Shtutgard

Evropiani

Shoqëron vetminë para një gotë birre.
Vet krijon mërzinë e moçme të njeriut.
Si moti është: dhe mjegullë, dhe shi.
Në ecjen e turbullt të saj kridhet
më i ngulur në vete.
Skeptik krruan mjekrrën.
Prej lëndinës së këmishës
fluturat lëvrijnë, tremben,
e fluturojnë.
Ai i kap brenda qiellit të syve të tij,
duke folur me vete dhe me gotën e birrës.-
Atje, në një hutim të trishtë,
të takon ty.

Belford. 1994

Të mbyllura dyert Skeé në Shtutgard

Në Shtutgard në ora 21 e 20'.

Natë-dashuri e Shtutgardit!
rreth kështjellës sate
Akili shpirtzi heq zvarrë trupin tim.
Po, jam hektori, bir i Priamit Dardan,
moj Evropë...

Prej Ballkanit, i pistë, tradhëti e gjak...
Si të hy unë sonte
në gjumin e Shtutgardit?
Mbyllma derën,
mbyllma derën si troja Hektorit,
moj natë e Evropës.

Çuar prej varri gjer në Shtutgard...
Si t'u truhem unë dashurive të mia këtu?
Të mbyllura dyert Skeé
në 21 e 20' në Shtutgard.

Shtutgard
25 janar'95

Në Shtutgard

Nëpër rrugët asfalt e mjegullë
të Evropës,
takova njeriun reklamë,
bërë prej letrash higjenike.-
M'u përshfaq Jesu Krishti.
Shikimi nënqeshës, hyjnor,
mbushte ajrin
me fëshfërimat e gjelbra
të gjethes së fikut.

Në stacionin Sen-Zhan de Murien

Në stacionin Sen-Zhan de Murien
hyri dimri nga jashtë:
drithtërimë e bardhë, e damës franceze,
në kabinë të trenit, spërkat hënë e borë.
Mornica ngrice hedh tek unë...
Një dorë e fortë ka skulpturuar
këto shpatulla mermeri; të limonta
dy gjysëmhenat e gjoksit,
më çojnë prapa, atje
nën strehët e Jonit tim, ku jeta
vdesë me spërkatje bënore në buzë.
Më ndjell humnerë e ijeve hollake,
qëndroj mbi ujërat shkumorë,
të tejdukshëm të lumit malorë,-
kofshëve të saj.

Veç, fytyra... Një si vetullë e brymtë,
gadi prej frymës sate shpërbëhet;
balli i ngushtë për një gjysëmputhje;
prej drite poroze kërcët e nofullave,
thyen e të mbesin në dorë... Në punë e sipër
zoti është lodhur, apo si një artist,-
në padurimin e vet
shkujdesshëm hodhi ca linja të ajrta?

Sen-Zhan de Murien, 1994

Duke u nisur për Zyrih

Të lesh Tiranën, të lesh Tiranën...

Strehohet shiu ndën gjethe manjolas,
zëra joshës ujrash e mashtrimesh.

Të lesh Tiranën! femër e tëra jotja,
me gjinj të fortë epshorë intrigash.

Të lesh Tiranën...

Te Pallati i mermertë i Kongreseve
- veshë më veshë - thashethemet
qeverisin qeveritë e fatet.

Dhe fatet janë si njerëzit,

Fatet thonë:-Ku dihet se si e kemi fatin?

Hajdute të vogla shpresat, të çndershme,
me duar të pafajshme bulevardesh,

xhepave të zemrave vjedhin; shpresat
putana përherë të njoma,

krahët t'i lakojnë qafës, litarë

ku ti varesh vetë.

Të lesh Tiranën! Dy sy

liqejsh të kthjellët, të thellë intrigash,

dinakërisht hokatarë e të dashur.

Të lesh Tiranën për një palo Zyrih

ku dielli me gjuhë lëpin Zvicrën e ndytë,
që ta pastrojë.

5 shtator '94

Duke u larguar prej Zyrihut

Këtu Kronosi i urdhërohet zemrekut të Zvicrës.
Akrepi i ajthëm urdhëron
rrahjet e zemrës së bankave e të aeroporteve.
I shëndetshëm pylli gjer në pamundësi;
bari i njomë e di se kur duhet të mbijë;
kur duhet të përkunden qerpikëve të syrit
liqenet dhe pikat e lotëve, e dinë.
Gjithçka është zbutur këtu.
Vetëm dielli atje lartë,
si diçka e hedhur rastësisht,
prej kohe djegur përbrenda.
I trembur Zoti i Kaosit është strukur
në një çip të njeriut:
-Ah, jugu... rebeli i ndohtë,
kaotik e hyjnor... më pëshpërit tinëz.

14 shtator '94

Në Tiranë ka vetëm tiranë

Në Tiranë ka vetëm tiranë, në Tiranë.

Në Tiranë të vrasin të gjithë:

një shetitje me veten të vret.

Mos e ndill kujtimin në Tiranë,

është tmerrësisht i pamëshirshëm.- të vret.

Mos guxo të shohësh në sy lirinë në Tiranë,-

dielli i syrit shuhet, shkërmoqet e zhbëhet.

Ti i barabartë me lirinë? -Mos e besol

Liria të vret.

Hipokrite shpresa sy-picigjate e Tiranës:

ti i vdekur - e ajo me gojën e saj të jep frymë,

të ngjallë që sërisht ty të vrasë - të vret.

Eshtë tjetër, tjetër trishtimi i tetorit në Tiranë,

vjen duke ikur - të vret.

Si Krye-Engjëlli, Sovrani i zyrtarë, ferrin e tij -

e dua Tiranën se të vret.

Zhgënjimi le të na bekojë...

Ali Aliut

Përsëri dikush përgjon vdekjen tonë.

Unë i ktheva akrepat në orën zero.
Të vdekurve u është mohuar nëndheu
dhe te këmbët tona shpirtrat e territ
frikshëm kanosen.

Pak dritë këtu, më pak errësirë atje,-
a të kujtohet Aliu im, në orën zero?

E kam gojën të hidhur...
Më ardhka keq për vet tragjedinë:
sa paska humbur prej dinjitetit të saj!
Maska është më e vërtetë se fytyra e mjerë.

Gjysmëfantazmat po retushojnë ndërgjegjen:
luajnë rrenash:
u kërkon nderin? - E japin.
U kërkon turpin? - E japin.

Bekuar qoftë zhgënjimi:
mbi kryet tona, ai e shtriftë dorën,
si im atë, i gjori, në çastin e fundit.
Zhgënjimi le të na bekojë.

Përpara janë gërmadhat e fateve
dhe shpresa, që mbeti duke gënijer vetveten,
shpalosi flamurët e vet të pashpresë.
Një lot gëzimi më përvidhet syrit,
të shuaj tek unë
prushanën e Ferrit.

12 shkurt 1992

Të shtunën në Vlorë

Të tjerë janë njerëzit. Kujtimet
në fund të tunelit të errët,
ndezin të vetmin kandil
ku mund të kërkoj vetveten;

Unë flasë e askush s'më beson
për narcizat e fëmijërisë.
E ndryshkur në sy të pulëbardhës
drita e diellit; këtu i vranë ullinjtë.
Askush s'kujtohet për vdekjen
e mëllenjës së shkrutit.
Unë flas e askush s'më dëgjon.

Dikush më shkon para
me shpirtra - joshpirtra - në shportë.

Përpiqem... e s'e njoh dot Vlorën.

Besnike e vetme
kjo flutur që loz me kohën
e kreshtën e detit.
Po unë e paskam harruar gjuhën e valëve,
jam hidhëruar me detin.

Në Vlorë - pa Vlorën -
të shtunën.

Shiu i parë

Ai i trembej takimit të udhëve,
prekjes së gjetheve,
i druhej dafinës këtu tek dritarja.
Rigoni i pjekur mos të shpërbëhej...
Ai donte t'i lajmëronte më parë
foletë e zogjve,
spërkatjen e lëmuar të guguftuve.
Sillte me vete vjeshtën, gruan
me trishtimet e pjekura.
Vërtetë disa të vdekur prej kohe,
por përsëri trishtime ishin.
Si gjethet
zemrat e njerzve përkuleshin
nën peshën e ujrave
me dhimbje të njoma.

Në qerpikët e mi një brerimë lotësh.
Nuk e kuptoja përse...

Përnjëherësh bubulliti - e qielli
gjëmoi brenda meje.-
Shiu i moçëm ecte rrëmbyeshëm tek unë.

1987

Do të vi vetmia e s'do të më gjejë

Patjetër që do të vi shiu.
Patjetër dikush do të vi.
Edhe ti, e pambritura prej kohe.
Ku, me cilin ke qenë gjer tani?
Sytë pyesin. Goja - jo.
Goja thotë:-Patjetër që do të vi shiu
me ecje prej ere e uji.
Diku po dukesh ti, e harruara,
dyshim e dhimbje, grindje,
pendim që kthehet në shi.
E di rrugën, kalldrëmet, derën.

Para teje dikush trokiti.

Vetëtima në krahun e zogut. Zëra...
Bubullima që shkel mbi rozmarinë. Era...
Unë u çova,-
jam nisur një çast më parë
në udhën, që s'e mohoj dot.

Hapet dera
dhe fletët e dritareve përplasen.

Do të vi vetmia e s'do të më gjejë.

Perëndim dielli në Zvërnec

Ah! Zoti i diellit...

U ndal lartë në majë, zbret poshtë në fushë.

Me rezet-gishtrinj.

diçka po gërvisht, diçka po gërmon,

sikur loz, sikur ç'loz,

e nga xhepat zbrazë thërmolat e vetes.

Shkund të fundmet thërmola

dhe shuhet - Zoti i diellit.

Të zbresë prej këtij kryqi dua

Duke ecur, eklipsi i diellit
rrëzohet e bie...

I mundur, si t'i shpëtoj vetes?
E mundur, si të shpëtoj vetja prej meje?

Profet i rremë
në skelete lirish kryqëzuar.

Të zbresë prej këtij kryqi dua.
Përthyer mbi veten time,
si një natë me shi
të rënkoj, të shfrej
e të humb.

Zoti ikte nën shi...

Tirana ikte nën shi, grua e rrahur.
Unë dhe Pritja - gri e vrarë, e mardhur.
Urija shponte shikimin, halë në sy.
Unë dhe Mërzia - mërzy, të prisnim ty.
Pëllumba përbaltur në shi, çizmet e tua,
pellgje të turbullt braktisjesh, ecnin mbi mua;
pellgje zhgënjimesh të ndrojtura, pëllumba të pistë,
tek unë ngjeshnin gjurmët:kryqëza-kryqëza
dashurish.
Mjerimi,-vdekje sovrane,- mblidhte dhe shpresat e
mia.
Në Tiranë nën shi ikte zoti, mbetej vetëm dashuria.

1991

Qiriri

N.

Fundi i qiririt digjej, flaka ndizej më shumë.
Shpirt i zërave të dritës tek ne të dy.
Kujtimi me sy të trembur ishte aty.
Dhomëza e vogël - krahor njeriu -
brenda tij shpirti i dritës pa zhurmë
zgjatte duart nga ty e nga unë.

Ikte vdekja e dritës në një mall pafund.

1991

Një cigar për të dy

Një cigar për të dy. Goja ime dhe jotja.
Zjarri i vjetër, i vjetër sa vet zoti.
Uh, që qenkam mërzi mu në zemër të çlodhjes.
Uh, tri herë uri! Në tejngopjen e botës.
Lemshej tymi të kaltër harrimi prej reve:
ja ku ktheham sërish nëpër rrugën nga erdhëm...
Dhjetori i Tiranës, vetmi e ngricë.
Sy të dhembshur, të dhembshur, si vdes qeni besnik.
Pa dashur në udhë thyej mitet me këmbë.
Mjerimi i vetvetes më fyen, më çmend.
Kanata zhgënjimi përplasen në erë,
tragjedia shqiptare sa vet zoti e vjetër.
Kam shpresën nër duar, poqë të djegur...
O zot, si t'a ndez, kur qiejt kanë vdekur?
Krishtin tim pashë në dy hunj ulliri.-
Ti edhe krishti
më pé mbërthyer në mëshirë.
Uh, që qenkam shpirt, mu në shpirtin e vrarë.

Një cigar për të dy.

Një cigar për të dy.

Njëqind jetë pa ty, asnjë jetë.
Njëqind vdekje me ty, asnjë vdekje.

Dashuria për ty e vjetër sa zoti.

1990

Pasqyra e lëndës

In - tenebris	4
Dhe ti beson se drita nuk vritet?	5
Akeronti rrjedh, po Karont nuk ka	6
Ke lindur për qiej të tjerë	7
Nuk dua të bëhesh kujtim	8
S'ja vlen të trishtosh zemrën tënde	9
Të gjitha të duhen	10
Sikur liria të ishte vetëm një lavire	11
Vet tragjedia kishte hu, bur udhën	12
Në bibliotekën tënde	13
Diell shpërfillës	14
Ti i fundit shpirt i furtunës	15
Askush s'e ka parë diellin kështu	16
Nëna u nisë	17
Shpresa e çmëndur... ..	18
Mall për ty në Tiranë	19
Ku është Kaini?	20
Përshpirtje për Villasin	21
Shqiptarët	22
Mashtrojnë horizontet	23
Ka dalë Akeronti prej shtratit të vet... ..	24
Një pikëllim i lirë... ..	25
Ngjarje	26
Në vorrezën e fshatit	27
Herë - herë Penelopës	28
Dhe je Evropë	29
Evropa e pakapshme si ndarja	30
Evropiani	31
Të mbyllura dyert Skeé në Shtutgard	32
Në Shtutgard	33
Në stacionin Sen-Zhan de Murien	34
Duke u nisur për Zyrih	35
Duke u larguar prej Zyrihut	36
Në Tiranë ka vetëm tiranë	37
Zhëgjërimi le të na bekojë... ..	38
Të shtunën në Vlorë	39
Shiu i parë	40
Do të vi vetmia e s'do të më gjejë	41
Perëndim dielli në Zvërnec	42
Të zbresë prej këtij kryqi dua	43
Zoti ikte nën shi... ..	44
Qiriri	45
Një cigar për të dy	46